



Prishtinë, 27 prill 2017  
Kodi i ZRRE: V\_913\_2017

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Neni 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Neni 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Dispozitat e Parimeve për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (SHST) dhe taksave të kyçje;
- Vendimin V\_907\_2017 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OST/OT;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST);
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Tregut; dhe
- Aplikacionin e KOSTT SH.A për miratimin e tarifave të OST/OT në kuadër të Shqyrtimit Njëmbëdhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHT11), të dorëzuar më datën 25 prill 2017,

në seancën e mbajtur më 27 prill 2017 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHEN** tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut, për vitin relevant tarifor apo SHT11, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) Sh.A.
- II. Struktura e tarifave për KOSTT SH.A, e cila do të zbatohet nga data 1 prill 2017, për vitin Relevant tarifor SHT11 do të jetë si në tabelën e mëposhtme:


GRUPI TARIFOR	ELEMENTI TARIFOR	NJËSIA	TARIFA
Prodhimi i Kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.420
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.037
Prodhimi i Kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.054
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.037
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.499
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.044
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW/vit	6.081
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW/vit	11.731
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.499
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.044
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	1.763

## ARSYETIM


- ✚ Rregullatori më datë 25 prill 2017 ka pranuar nga KOSTT SH.A, aplikacionin për tarifave OST/OT.
  - ✚ Rregullatori për vendosjen e tarifave për OST/OT, ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj si në vijim:
    - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OST/OT-së, i publikuar më datën 28 Shkurt 2017; dhe
    - Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OST/OT, i publikuar më datën 31 Mars 2017;
- III. Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të zbatohet nga KOSTT SH.A. për vitin relevant tarifor SHTE11 dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**



Krenar Bujupi, u.d kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.